

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mirëmbajtje e infrastrukturës së IT për 3 vite

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Paketa software dhe sisteme informacioni
- Paketa software për industri specifike.

VLERA E FONDIT LIMIT:

120.985.310 leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (tre vitet e fundit) 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit për këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter është vendosur në mënyrë që të garantohet një nivel i pranueshëm në lidhje me eksperiencën, besueshmërinë, përvojën në kontrollin e llogarive të entiteteve të krahasueshme.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të shërbimeve të mëparshme të mirembajtje të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak 40 % nga vlera e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera ,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë.

- a) ISO 9001:2015: Për menaxhimin e cilësisë, që ka lidhje me objektin e kontratës – *Mirembajtje TIK*;
- b) ISO 20000:2018 Për menaxhimin e sistemeve të informacionit, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit – *Mirembajtje TIK*;
- c) ISO 27001:2022 Për menaxhimin e sigurisë së informacionit, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit – *Mirembajtje TIK*;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qenë se sistemi pjesë e prokurimit është e rëndësishme për sigurinë dhe vijueshmërinë e punës të sistemeve kritike në APD duhet që subjektet zbatuese të kontratës të jenë të pajisura me këto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është e rëndësishme për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

- Përmbushja e standartit ISO 20000:2018 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen dhe që lidhen me mirembajtjen e sistemeve. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.
- Përmbushja e standartit ISO 27001:2018 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar që shoqëritë zoterojnë njohuritë si dhe procedurat e menaxhimit të sigurisë së informacionit që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të sigurisë.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për zbatimin e kontratës, duhet të ketë personelin kryesor, si më poshtë:

- a. *1 (një) Administrator Projekti PMP* ose ekuivalent; me eksperience pune si administrator projekti prej më së paku 3 vite; i anashkuar në kontrata të mëparshme për zbatimin si dhe mirembajtjen e sistemeve TIK në kompleksitet si dhe rëndësi të ngjashme me ato përfshira në Termat e Referencës;

Argumentim: Personi kerkohet të mundësojë një administrim të burimeve njerezore si dhe të jetë i aftë të ndjekë dhe garantojë koordinimin me efikasitet të burimeve të Operatorit TIK për të garantuar përputhjen e veprimtarisë me nevojat e Autoritetit Portual. Këto burime, duhet të jenë të afta të mbështesin prirësitë apo nevojat e Portit dhe të përshkruajnë me kërkesat apo zhvillimet që Autoriteti Portual (APD) do të ketë përgjatë zbatimit të kontratës së Mirembajtjes TIK. Suksesi i zbatimit të shërbimit të mirembajtjes në një masë të madhe nga mënyra e përshkruarjes së burimeve të operatorit ndaj kërkesave gjithnjë e më rritje të APD.

- b. *1 (një) Personel Administrativ TIK* me të paktën 3 vjet eksperience në këtë fushë dhe të certifikuar si ITIL (Information Technology Infrastructure Library) ose ekuivalente, i cili do të drejtojë aktivitetet që lidhen me shërbimin e suportit si dhe të mirembajtjes të sistemeve.

Argumentim: Personeli kerkohet të ketë njohuritë dhe eksperiencën në proceset që lidhen me mirembajtjen e pajisjeve dhe sistemeve TIK. Në mënyrë të vecantë këto procese mirembajtje kërkojnë një koordinim të operacioneve njerez-sisteme.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit, CV-në e personelit dhe vërtetimet nga zyrtarët tatimorë që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrtarët tatimorë taksivë. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkriptive perkatese. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, sipas kategorive më poshtë:

a) Kategoria 1 (Kritik / i Lartë)

Kerkesa	Argumentimi
1 (një) punonjes te certifikuar per software TOS nga prodhuesi ose ekuivalent Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe deklaratë të institucionit certifikues për ekuivalencën, së bashku me një raport krahasues që vërteton përputhjen teknike. Autoriteti Portual Durres rezervon të drejtën të verifikojë teknikisht pretendimet e ofertuesit për ekuivalencë.	NAVIS është një Terminal Operating System (TOS) kritik për menaxhimin dhe optimizimin e operacioneve portuale. Ai kontrollon dhe koordinon lëvizjen, magazinimin dhe përpunimin e kontejnerëve në terminal, duke siguruar efikasitet maksimal, siguri dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Çdo ndalim i NAVIS paralizon operacionet e portit, duke shkaktuar humbje të mëdha financiare, vonesa në transport. Për këtë arsye, mirëmbajtja e tij duhet të bëhet vetëm nga specialistë të certifikuar NAVIS ose ekuivalent, me kohë reagimi maksimumi 0-1 orë për të shmangur ndërprerjet dhe dëmet në operacionet portuale.
1 (një) punonjes te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per sistemin e Firewall ekzistues ose ekuivalent Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe deklaratë të institucionit certifikues për ekuivalencën, së bashku me një raport krahasues që vërteton përputhjen teknike. Autoriteti Portual Durres rezervon të drejtën të verifikojë teknikisht pretendimet e ofertuesit për ekuivalencë.	Mirembajtja e sistemit Firewall Chekpoint, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit per aplikimin e politikave te sigurise dhe monitorimin e trafikut ne hyrje dhe dalje. Cdo perdorues fundor qe perdor aplikacionet kritike te autoritet (duke perfshire edhe systemin TOS) kalon dhe filtrohet nga firewall qendror i autoritetit Portual. Ne keto paisje aplikohet te gjitha politikat e sigurise dhe grupimet e aksesit per te gjitha paisjet dhe perdoruesit fundore. Instalimi I updateve dhe I patcheve te fundit eshte kritik per keto paisje si dhe zevendesimi i komponenteve hardware ne rast difektshmerie.
2 (dy) personel te certifikuar ne nivel profesional per serverat e infrastruktures ekzistuese nga prodhuesi ose ekuivalent.	Mirembajtja e paisjeve hardware servera ku hostoen sherbimet virtuale, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit ekonomik. Ne keto paisje procesohet cdo informacion I infrastruktures virtuale (si makina virtuale,

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe deklaratë të institucionit certifikues për ekuivalencën, së bashku me një raport krahasues që vërteton përputhjen teknike. Autoriteti Portual Durres rezervon të drejtën të verifikojë teknikisht pretendimet e ofertuesit për ekuivalencë.	databaza, shërbime web, aplikacione të brendshme, active directory, etj). Instalimi I updateve dhe I patcheve të fundit është kritik për keto paisje si dhe zëvendësimi i komponenteve hardware në rast difektshmerie.
1 (një) personel të certifikuar në nivel profesional për storage e infrastrukture ekzistuese nga prodhuesi ose ekuivalent. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe deklaratë të institucionit certifikues për ekuivalencën, së bashku me një raport krahasues që vërteton përputhjen teknike. Autoriteti Portual Durres rezervon të drejtën të verifikojë teknikisht pretendimet e ofertuesit për ekuivalencë.	Mirembajtja e storage, është një detyrë kryesore të Operatorit ekonomik. Në keto paisje ruhet dhe magazinohet çdo informacion i infrastrukture virtuale (si makina virtuale, databaza, shërbime web, aplikacione të brendshme, active directory, etj). Ngarkesa ndahet në të dyja paisjet të cilat kanë vendodhje gjeografike të ndryshme në formë active-standby duke siguruar që informacioni të ndodhet në dy vende njëkohësisht. Instalimi I updateve dhe I patcheve të fundit është kritik për keto paisje si dhe zëvendësimi i komponenteve hardware në rast difektshmerie.
1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për sistemin e backup nga prodhuesi ose ekuivalent. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe deklaratë të institucionit certifikues për ekuivalencën, së bashku me një raport krahasues që vërteton përputhjen teknike. Autoriteti Portual Durres rezervon të drejtën të verifikojë teknikisht pretendimet e ofertuesit për ekuivalencë.	Mirembajtja e sistemeve të backup është një detyrë kryesore të Operatorit për të siguruar informacionin në rastin e sulmeve kibernetike dhe mundësive të korrupsionit apo humbjes së të dhënave. Aplikimi i politikës “retention lock” është shumë i rëndësishëm për të siguruar që kopjet e magazinuar në këto paisje të mos ndryshohen dhe çdo përdorues mos të ketë mundësinë për të bërë “write” mbi keto backup. Politika e aplikimit të kohës së mos ndryshimit të backup do të përcaktohet nga autoriteti kontraktor në një periudhë 3 muajore duke ndryshuar kohën e ruajtjes së të dhënave në bazë të rëndësise. Instalimi I updateve dhe I patcheve të fundit është kritik për keto paisje si dhe zëvendësimi i komponenteve hardware në rast difektshmerie.

b) Kategoria 2 (Kritik / i Mesëm)

Kërkesa	Argumentimi
1 (një) personel të certifikuar në platformën e administrimit financiar (Oracle ose ekuivalente);	Sistemi Oracle është aktualisht në përdorim në fushën e administrimit financiar.

2 (dy) personel te sisteme te raportimit (Business Intelligence Oracle/Microsoft ose ekuivalente);	Sistemi qe eshte aktualisht ne perdorim ne fushen e raportimit financiar dhe operacional te APD.
2 (dy) personel te certifikuar ne bazat e dhenave (RDBMS) (Oracle, MySQL ose ekuivalente);	Keto sisteme RDBMS jane me te perdorurat ne APD. Problematikat ne operimin e bazave te dhenave mund te shkaktojne vonesa ne operimin e te gjitha sistemeve, qe mbeshteten ne to.
1 (një) personel te certifikuar per manaxhimin e pajisjeve qendrore te rrjetit Cisco CCNP ose ekuivalent;	Mirembajtja e pajisjeve qendrore te rrjetit eshte nje detyrim i Operatorit. Problemet me operimin e Switcheve qendrore apo paisjeve te rrjetit qe mundesojne “switching dhe routing” do te sillnin mosfunksionim per komunikimin e infrastruktures dhe software qe mbeshteten te funksionimin e tyre.
2 (dy) personel te certifikuar per teknologjite GIS/ESRI ose ekuivalente;	Mirembajtja e sistemit GIS, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit.
1 (nje) punonjes te certifikuar per administrimin e sistemeve ne Cloud (Oracle/Microsoft, ose ekuivalent);	Mirembajtja e sistemeve ne cloud si dhe ne distance, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit.
1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemet Akses Kontrolli	Mirembajtja e sistemeve dhe paisjeve per kontrollin e aksesit te kembesoreve dhe mjeteve eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit.
1 (nje) personel te certifikuar ne sisteme te virtualizimit te serverave (vmware) ose ekuivalent;	Mirembajtja e paisjeve, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit.
1 (nje) personel te certifikuar ne sistemet operative server (Microsoft, ose ekuivalent);	Mirembajtja e sistemeve, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit pasi pjesa me e madhe e sherbimeve
1 (një) punonjes te certifikuar per sisteme EDR	Mirembajtja e sistemit EDR, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit per kufizimin dhe monitorimin ne kohe reale te sistemeve kritike, perdoruesve fundore dhe parandalimin e kercenimeve te brendshme e te jasthme.

c)Kategoria 3 (Kritik / i Ulët)

Kerkesa	Argumentimi
2 (dy) personel te certifikuar ne rrjetat kompjuterike (CompTIA Network Plus/CCNA ose ekuivalente);	Mirembajtja e rrjetave, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit. Probleme ne operimin e rrjetit do te sjellin problem ne mireoperimin e te gjitha sistemeve qe mbeshteten ne to.

2 (dy) personel te certifikuar ne sistemet operative per desktop (Linux, Microsoft, ose ekuivalent);	Mirembajtja e sistemeve te operimit, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit.
--	---

Argumentim:

Ne baze te kategorive te ndryshme te sistemeve qe APD disponon me poshte eshte bere nje ndarje sipas kritikalitetit dhe rendesise se ketyre sistemeve. Kategoria kritike kerkon angazhim maksimal ne pergjigje dhe njohuri per operatorin ekonomik pasi afekton komponente jetike te institucionit pa te cilat afektohen sherbime duke penguar aktivitetin operacional. Percaktimet e detajuara ne lidhje me kritikalitetet jane sipas tabelës me poshte:

Kohet e Pergjigjes dhe te Zgjidhjes

Kodet e kritikitetit perdoren per te percaktuar kohen e duhur te pergjigjes dhe te zgjidhjes. Kohet e pergjigjes dhe te zgjidhjes llogariten qe nga momenti i hapjes se incidentit nga Grupi e Kontaktit te Kompanise. Nqs problemi nuk zgjidhet ne kohen e percaktuar, duhet te aplikohen perpjekje te vazhdueshme derisa problemi te rezultojë i zgjidhur.

Kategoria 1 (Kritik/ I Larte)	Kategoria 2 (I Mesem)	Kategoria 3 (I Ulet)
Sistemet dhe pjese te tjera kritike te sistemit jane plotesisht jashte pune.	Mosfunksionim pjesor infrastrukture. Probleme me komponente kritike qe jane redundante dhe jane objektivi i keqfunksionimit te High Availability. Probleme ne performance.	Mosfunksionimi i infrastruktures prek nen 15 % te sherbimeve ne suportit
Numri i perdoruesve te ndikuar		
Mos funksionim total i sistemit.	Mos funksionimi ndikon nje numer <i>te vogel</i> te perdoruesve	Mos funksionimi ndikon pjeserisht vetem perdoruesit e nje departamenti/njesie
Pezullimi i punes		
Mos funksionimi pengon te gjithë perdoruesit <u>te realizojne punen e tyre.</u>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne pjese te punes se tyre qe kane lidhje kryesisht me institucione te tjera</u>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre.</u>
Zgjidhje alternative e perkohshme		
<u>Nuk ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjeserisht nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	<u>Ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.
Koha e pergjigjes		
- o 5~15 min. per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 1 ore.	- o 30 min per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 8 oreve	- o 1 ore per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda dites se neserme te punes

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit aty ku kërkohet, CV-në e personelit dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklarinimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkriptëve perkatese. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një personel prej të paktën 20 personash. Kjo do të vërtetohet nga deklarinimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. për të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Ky numer i përgjithshëm punonjësish vlerësohet minimal për të garantuar zbatimin si dhe mirëmbajtjen e suksesshme. Numri i përgjithshëm i personelit jo më pak se 20, është bërë për të garantuar që operatori ekonomik ka strukturën organizative, eksperiencën si dhe organizimin e duhur për të marrë përsipër një ndërmarrje të tillë ku refruar edhe ToR minimalisht 8 specialiste (nga stafi aktual) do të agazhohen në zbatimin e kësaj kontrate mirëmbajtje. Verifikimi i certifikatave është thelbësor për të kontrolluar vërtetësinë e tyre dhe nivelin e certifikimit sipas kërkesave nga prodhuesit ose organizatat e licensuara ndërkombëtare për trajnime specifike.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Arsyetim për mosndarjen e procedurës në lote

Kontratën e mirëmbajtjes nuk e kemi ndarë në lote të veçanta sepse e konsiderojmë këtë shërbim si një paketë të integruar, ku çdo komponent lidhet ngushtë me të tjerët. Për të garantuar një funksionim të qëndrueshëm, efikas dhe pa ndërprerje të sistemit, është e rëndësishme që mirëmbajtja të trajtohet në mënyrë të centralizuar dhe të unifikuar.

Fragmentimi në lote do të sillte rrezik për mbivendosje përgjegjësish, mungesë koherence në zgjidhjen e problemeve dhe vonesa në reagim. Në vend të kësaj, ne ofrojmë një zgjidhje të plotë që përfshin të gjitha aspektet e mirëmbajtjes – që nga përditësimet teknike dhe siguria, deri te mbështetja teknike dhe kontrolli i performancës – për të siguruar cilësi të lartë dhe përgjegjësi të qartë. Për më tepër, një kontratë e pandarë lejon që të ruhet konsistenca në cilësinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes. Ajo mundëson një komunikim të drejtpërdrejtë dhe të qartë mes palëve, si dhe eviton çdo keqkuptim apo vonesë që mund të lindë në rast të koordinimit mes ofruesve të ndryshëm. Në këtë mënyrë, sigurojmë jo vetëm mirëmbajtje të vazhdueshme dhe proaktive, por edhe përmirësim të vazhdueshëm të sistemit në bazë të analizave të performancës dhe nevojave reale të përdoruesve.